



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

20646
Nr. _____ Prot

Shkodër, më 14.10.2025

Lënda: Dërgohet projekt- vendim dhe relacion

KËSHILLIT BASHKIAK, SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur ju dërgojmë për kompetencë shqyrtimi projekt-vendimin dhe relacionin:

“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE TË EKONOMISË PYJORE “ROSEK DRISHT” DHE “DRIN GJADER KIR” BASHKIA SHKODËR.”

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR
Benet BECI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E MJEDISIT DHE ENERGJISË SË RINOVUESHME

20640/1
Nr. _____ Prot

Shkodër, më 14.10.2025

RELACION
MBI

“MIRATIMIN E PLANIT TË MBARSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE EKONOMIA PYJORE “EKONOMIA PYJORE ROSEK DRISHT” dhe “DRIN GJADER KIR”

Bashkia Shkodër pjesë të funksioneve të saj, ka edhe administrimin e qëndrueshëm të fondit pyjor kullësor kjo sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Sipërfaqja pyjore që administron Bashkia Shkodër bazuar në VKM nr. 433 dt 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të MM e të ish komunave/bashkive” i ndryshuar me VKM nr 684/2020 si edhe VKM nr 59 dt 26.01.2022 “Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemeve natyrore park kombëtar (kategoria ii) të zonave të mbrojtura mjedisore” dhe VKM nr 60 dt 26.01.2022 “Për shpalljen e ekosistemeve natyrore rezervat natyror i menaxhuar/park natyror (kategoria iv), si dhe miratimin e ndryshimit të statusit e të sipërfaqeve ekzistuese të zonave të mbrojtura mjedisore, që i përkasin kësaj kategorie”, është gjithsej **30.668 HA ha.**

Në këtë kuadër Bashkitë janë pronarët legjitimë dhe administrator të pyjeve e kullotave brenda territorit administrative. Mbrojtja e pyjeve si pasuri me rëndësi të veçantë, për vlerat e mëdha dhe të pazëvendësueshme në mbrojtjen e klimës, të tokës, ruajtjen dhe përmirësimin e potencialeve prodhuese, të ekuilibrave të mjedisit natyror, biodiversitetit, burimeve gjenetike dhe regjimit hidrik, është detyrim me interes bashkiak , rajonal e kombëtar .

Administrimi i pyjeve realizohet nepermjet procesit të Mbarështimit të Pyjeve që është planifikimi afatgjatë i cili kryhet në bazë të kriterëve të caktuara për grumbullimin e informacionit për situatën/gjendjen faktike dhe përcaktimin e objektivave e masave të nevojshme, me synim përmbushjen e funksioneve ekologjike, ekonomike e sociale, duke zbatuar dhe harmonizuar parimet e zhvillimit të qëndrueshëm me nevojat e administruesve, pronarëve privatë dhe përdoruesve të tyre.

Ky process mbarështimi realizohet nëpërmjet Planeve të mbarështimit si dokumenti bazë për mbarështimin e një ekonomie pyjore, që përmban analizën e gjendjes së pyjeve, përcakton objektivat që duhet të realizohen në funksion të statusit që kanë, si dhe planifikon masat për trajtimin e tyre dhe ndërhyrjet për vitete ardhshme.

Aktualisht sipërfaqja pyjore kullësore e bashkisë administrohet nëpërmjet 11 Ekonomive pyjore. Në kuadër të administrimit të sipërfaqeve pyjore nga ish-komunat të cilat kanë patur në pronësi një pjesë të sipërfaqeve pyjore dhe kullësore, janë hartuar disa plane mbarështimi të cilat nuk

përputheshin me standartet profesionale dhe teknike të hartimit të planeve të mbarshtimit sikurse në të njëjtën kohë edhe këto plane janë të pavlefshme për shkak të mbarimit të afatit 10 vjeçar.

Bashkia Shkodër duke vlerësuar detyrimin për hartimin e planeve të reja të mbarshtimit të fondit pyjor dhe kullësor, që rrjedh nga legjislacioni i fushës, ka ndërmarrë procesin për hartimin e planeve të reja aktualisht për ekonominë pyjore **Rosek Drisht dhe Drin Gjader Kir**.

Ekonomia pyjore Rosek Drisht shtrihet në Njësinë Administrative Postribë me fshatrat e saj malore Drisht, Mes, Dragoc etj dhe lidhet me qytetin e Shkodrës nëpërmjet rrugës Shkodër Ura e Shtrenjte Prekal .

Përbërja e territorit për ekonominë ROSEK DRISHT është si më poshtë:

Nr	Emertimi	sip pyje/ha	sip HA kullote	sip HA Inproduktve	SIP TOT HA
	Ep Rosek Drisht	6310.0974	13.8968	499.76	6823.7542

Dhe Ekonomia Pyjore Drin Gjader Kir e cila shtrihet në perendim të fshatit Ganjoll në Nj.A Guri Zi.

Përbërja e territorit për ekonominë Drin Gjader Kir është si më poshtë:

Emertimi	Sip pyjore/ha	Sip kullote	Sip inproduktive/ ha	Sip totale/ha
E.P Drin Gjader Kir	11.98 ha	0 ha	139.09 ha	151.07 ha

Plani i ri i mbarshtimit të dy ekonomive pyjore përcakton hapat që do të ndiqen për zhvillimin e pyjeve dhe kullotave për një periudhë 10 vjeçare, duke i hapur rrugë në këtë mënyre investimeve në fondin pyjor dhe kullësor nëpërmjet (a) pyllëzimeve të reja dhe rehabilitimit të zonave të dëmtuara, (b) shfrytëzimit të qëndrueshëm të pyjeve për nevojat publike, (c) rritjen e mundësive për mbrojtjen e shtresës së tokës nga gërryerjet/erozioni, (d) rritjen e prodhimit të lëndës drusore.

Si rrjedhim i drejtpërdrejtë, objektivi i përgjithshëm për planifikimin afatgjatë për ekonominë pyjore **Rosek Drisht dhe Drin Gjader Kir** përqëndrohet në tre përparësi madhore, të cilat janë parakushte vendimtare për të arritur një mbarështrim të qëndrueshëm dhe shumëfunksional:

1. Rritja e fondit pyjor, në drejtim të sasisë (volumi mesatar për hektar) dhe cilësisë (lënda drusore e prodhuar në pyjet trungishte). Ky PMPK duhet të shënojë një pikë kthese dhe një ndarje të qartë nga tendencat e mbishfrytëzimit të së kaluarës.

Qëllimi i ndjekur është gjithashtu përmirësimi i prodhimtarisë së pyjeve, si edhe i vlerës së përgjithshme të burimeve pyjore (produkteve drusore, sekuestrimit të karbonit, shtimit të biodiversitetit, mbrojtjes së tokës dhe pjellorisë së saj, përmirësimi i shëndetit dhe vitalitetit të ekosistemit).

2. Konsiderimi i funksionit mbrojtës ndaj tokës si faktor kryesor që duhet të zbatohet para çdo lloj ndërhyrje në pyje.

3. Zbatimi i praktikave të kullotjes racionale për t'u dhene mundesi per tu ripërtërirë dhe domosdoshmërinë për të ruajtur një mbulesë vegjetacioni të mjaftueshme.

Objektivat specifike për :

- ***Funksionin dhe regjimin qeverisës***

Lidhur me përdorimin e tokës ne parashikojmë që në periudhën 10 vjeçare të zbatimit të këtij PMPK, sipërfaqet me bimësi pyjore, të ruhen dhe te permirsohet gjendja e tyre ne menyre qe te kryejne funksionin mbrojtës te tokes.

- ***Për tipet pyjore***

Objektivi specifik lidhur me tipet pyjore është ruajtja e përbërjes ekzistuese të specieve dhe përmes ndërhyrjeve të përmirësohet gjendja e grumbujve pyjorë. Një objektivi tjetër do të jetë zëvendësimi i grumbujve pyjorë të vjetër në moshë me grumbuj pyjorë të rinj dhe instalimi i filizërisë në parcelat pyjore që do të shfrytëzohen.

- ***Specifike silvikulturore***

Në lidhje me objektivat silvikulturore për EP Rosek Drisht, synimi ynë është të ruajmë sipërfaqen pyjore dhe aplikimi i ndërhyrjeve silvikulturore, si pastrimet, rrallimet, prerjet e njepasnjeshe/ perfundimtare etj.për kullotat

Zbatimi i praktikave të kullotjes në përputhje me nevojën e grumbujve pyjorë për t'u ripërtërirë dhe domosdoshmërinë për të ruajtur një mbulesë vegjetacioni të mjaftueshme.

- ***Për biodiversitetin***

Biodiversiteti i kësaj ekonomie është nën presion për përdorim bujqësor e blegtoral, për prodhim të lëndës drusore, dru zjarri etj. Një rrezik i vazhdueshëm për këtë ekonomi mbeten edhe zjarret aksidentale por shpesh edhe të qëllimshme për motive të paqarta përfitimi.

Rreziqet kryesore për pyjet e ekonomisë pyjore Rosek-Drisht, përveç prerjeve abuzive dhe zjarreve janë edhe kullotja pa kriter, si dhe dëmtuesit dhe sëmundjet e ndryshme.

Plani parashikon masat afat gjata dhe ato afat shkurtra.

Sipas përlllogaritjeve për ekonominë e marrë në studim, si biomasë në dispozicion për plotësimin e nevojave energjitike mund të merret vëllimi i materialit drusor që del nga masat silvikulturore të planifikuara për dhjetë vitet që zbatohet ky plan mbarështimi. Pra përfitohet një sasi biomase prej **170262** ton/vit.

Sa më sipër në ekonominë pyjore Rosek-Drisht për **6823** ha pyje kullota dhe shkurre , me rritje mesatare **10963** m³/vit, llogaritet të sekuestrohet rreth **85131** ton CO₂.

Përfitimi i pritshëm në terma financiarë përfshin atë nga prodhimet e dyta pyjore jo drusore prodhim i lëndës drusore si për dru zjarri ashtu edhe lëndë punimi , apo dhënie në përdorim të sipërfaqes kullosore apo pyjore për aktivitete të parashikuara në legjislacionin sektorial.

Bazuar në këtë plan të ardhurat e pritshme parashikohen në masën 201 milion lekë ndërsa shpenzimet e parashikuara për tu kryer janë në masën 55 milion lek pra diferenca e kësaj balance është në favor të përfitimit ku një vlerë të konsiderueshme zë edhe përfitimi zvogëlimit të gazit CO₂

Natyrisht vlера e të ardhurave presupozohet të jetë më e madhe se sa ajo e përlllogaritur nëse këtu përfshihen edhe përfitimet mjedisore, si nga sekuestrimi i karbonit nga të mbjellat, vreshtat, foragjeret, pemët frutore, sipërfaqet me bimësi pyjore, drurët dekorativ nëpër kopshte private,

sipërfaqet ujore dhe projet me bimësi e tyre. Ka akoma më shumë rezerva në sasinë e grumbullimit të bimëve mjeksore, gjuetia dhe peshkimi e të tjera për komunitetin e zonës por edhe më gjërë.

Në mbështetje të nenit 3, nenit 8, të pikës 1 nënpika 1.1 shkronja “a” të nenit 9 , nenit 27 pika 5, nenit 54 shkronjat “k” të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, pikës 2 b të nenit 11 të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, ligjin nr. 5/2016 “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.. 433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish- komunave/ bashkive”, ndryshuar me VKM nr 684/2020

Ju ftojmë në miratimin nga ana Juaj!

Drejtoria e mjedisit, dhe energjise se rinovueshme

Aida Shllaku

K R Y E T A R

Benet BECI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ . 2025

PROJEKT VENDIM

NR. ____ , DATË ____ . ____ . 2025

“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE TË EKONOMISË PYJORE “ROSEK DRISHT” DHE “DRIN GJADER KIR” BASHKIA SHKODËR.

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ . 2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja ‘k’ e ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Nenin 11 pika 2/b e ligjit nr.57/2020 “Për pyjet”; Ligjin nr. 5/2016 “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin nr 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor” të ndryshuar; VKM nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive” të ndryshuar; dhe sipas relacionit nr. ____ prot, datë ____ të administratës të Bashkisë Shkodër.

V E N D O S I :

1. Të miratojë Planet e mbarështimit të pyjeve dhe kullotave për ekonominë pyjore **“ROSEK DRISHT dhe DRIN GJADER KIR”** Bashkia Shkodër të cilët do të jenë të vlefshëm për një periudhë 10- vjeçare, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Shkodër.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Benet BECI

Zv.Kryetar

Alban Zeqiraj

DREJTORIA E MËDISIT DHE ENERGJISË SË RINOVUESHME

Fieda Hilla

DREJTORIA E PERGJITHESHME JURIDIKE, BURIMEVE NJEREZORE DHE
SHERBIMEVE MBESHTETESE

Orsela Dama

Indira Zeqiraj